

Në përputhje me Kartën Olimpikë, Ligjin nr. 06/L-043 për Lirinë e Asociimit në Organizata Joqeveritare, Ligjin nr. 08/L-277 për Sportin, si dhe ligjet tjera përkatëse në Republikën e Kosovës, Asambleja e Përgjithshme e Komitetit Olimpik të Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 28 gusht 2025, miraton Statutin e mëposhtëm:

STATUTI I KOMITETIT OLIMPIK TË KOSOVËS

KAPITULLI I – DISPOZITA HYRËSE, QËLLIMI DHE PARIMET

Neni 1 – Qëllimi dhe qëndrimi themelor

1. Ky Statut është hartuar në përputhje me Kartën Olimpikë, e cila përfaqëson kodifikimin e Parimeve Themelore të Olimpizmit, rregullave dhe akteve nënligjore të miratuara nga Komiteti Olimpik Ndërkombëtar (KON), si dhe të gjitha ligjet e zbatueshme në Republikën e Kosovës.
2. Ky Statut rregullon organizimin, funksionimin dhe veprimtarinë e Komitetit Olimpik të Kosovës (në vijim: KOK), në përputhje me normat ndërkombëtare dhe legjislacionin vendor për sportin.
3. Në thelb, ky Statut ka për qëllim:
 - a. Të përcaktojë dhe të rikujtojë Parimet Themelore dhe vlerat thelbësore të Olimpizmit, si dokument me natyrë kushtetuese për KOK dhe anëtarët e tij;
 - b. Të shërbejë si akti bazë i qeverisjes dhe funksionimit të KOK, duke rregulluar organizimin dhe administrimin e tij në përputhje me Kartën Olimpikë dhe legjislacionin përkatës në Kosovë;
 - c. Të përcaktojë të drejtat dhe detyrimet kryesore reciproke ndërmjet KOK-ut, federatave sportive kombëtare, organizatave sportive, sportistëve, trajnerëve dhe akterëve të tjerë të përfshirë në Lëvizjen Olimpikë;
 - d. Të sigurojë përputhshmëri të plotë me Kartën Olimpikë, duke garantuar që të gjitha aktivitetet e KOK-ut, përfshirë organizimin dhe pjesëmarrjen në Lojërat Olimpikë dhe garat e tjera ndërkombëtare, të jenë në harmoni me rregullat dhe standardet e Komitetit Olimpik Ndërkombëtar;
 - e. Të saktësojë se KOK-u, si organizatë ombrellë, është autoriteti më i lartë sportiv në Republikën e Kosovës, dhe e ushtron veprimtarinë e tij në përputhje me Kartën Olimpikë, Kodin Botëror për Anti-Doping, legjislacionin në fuqi në Kosovë dhe vendimet e KON-it;
 - f. Të ketë për mision zhvillimin, promovimin dhe mbrojtjen e Lëvizjes Olimpikë në Republikën e Kosovës;
 - g. KOK angazhohet, në përputhje me misionin e vet, në aktivitete që promovojnë paqen dhe avancimin e grave në sport, mbështetjen e etikës dhe integritetit në sport, luftën kundër dopingut, dhe të demonstrojë përgjegjësi për mbrojtjen e mjedisit.

Neni 2 - Parimet Themelore të Olimpizmit dhe Sporti

1. Në realizimin e veprimtarisë së tij, KOK-u do të promovojë dhe do t'u përmbahet me përpikëri të plotë parimeve themelore të Olimpizmit të përcaktuara në Kartën Olimpikë.
2. KOK-u do t'i përmbahet parimeve themelore që garantojnë të drejtën e secilit individ për t'u marrë me sport, respektimin e parimeve të ligjshmërisë, qeverisjes së mirë dhe transparencës; garantimin e mosdiskriminimit dhe krijimit të një ambienti të sigurt dhe të favorshëm për të gjithë, me kujdes të veçantë për mbrojtjen e fëmijëve dhe të rinjve pjesëmarrës në sport; duke ruajtur privatësinë e pjesëmarrësve dhe duke mbrojtur mjedisin në përputhje me frymën e "Fair Play-it".

KAPITULLI II: EMËRTIMI, STATUSI JURIDIK, JURISDIKSIONI DHE SIMBOLET

Neni 3 – Emërtimi dhe statusi juridik

1. Emri i organizatës është **Komiteti Olimpik i Kosovës (KOK)**, i themeluar më 27 maj 1992 dhe i njohur nga KON më 9 dhjetor 2014.
2. KOK-u e ka selinë në Prishtinë, në Republikën e Kosovës.
3. KOK-u është organizata më e lartë sportive që qeveris Lëvizjen Olimpike në Kosovë.
4. KOK-u është organizatë joqeveritare dhe joprofitabile me kohëzgjatje të pacaktuar, e regjistruar në nivel vendi dhe me status të personit juridik, duke shtrirë juridiksionin e tij në tërë territorin e Republikës së Kosovës.
5. KOK mund të padisë dhe të paditet në emër të vet.
6. KOK-u vepron në pajtim me Kartën Olimpike, këtë Statut dhe legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës.
7. Përfaqësuesi ligjor i KOK-ut është Presidenti. Çdo korrespondencë drejtuar KOK-ut i adresohet Presidentit dhe/ose Sekretarit të Përgjithshëm.
8. Asetet, të hyrat dhe profitet e KOK duhet të përdoren ekskluzivisht për qëllimet dhe objektivat e organizatës dhe nuk mund të përdoren për përfitime personale, të drejtpërdrejta apo të tërthorta, të anëtarëve të saj. Kjo nuk e ndalon personelin e punësuar nga KOK për të marrë kompensim përmes kontratave të punës ose anëtarët e KOK për të marrë rimbursime të shpenzimeve të arsyeshme të lidhura me përmbushjen e funksioneve të tyre.
9. KOK ka vulën e vet, në formë katrore dhe të rrumbullakët.
10. Emblema zyrtare e KOK, e aprovuar nga KON, është si në vijim:

KOSOVO



11. Flamuri dhe emblemat e tjera të KOK-ut të përdorura në aktivitetet zyrtare, përfshirë Lojërat Olimpike, janë subjekt i aprovimit nga KON.

Neni 4 – Misioni, roli, objektivat dhe të drejtat

1. Misioni i KOK është të zhvillojë, promovojë dhe të mbrojë Lëvizjen Olimpike në Kosovë, në pajtueshmëri me Kartën Olimpike si dhe në pajtueshmëri me legjislacionin e aplikueshëm në Republikën e Kosovës.
2. Roli i KOK është:
 - a. Të promovojë parimet fundamentale dhe vlerat e Olimpizmit në Kosovë, në veçanti, në fushën e sportit dhe edukimit, duke promovuar programe edukative Olimpike në të gjitha nivelet e shkollimit, në institucionet dhe universitetet sportive dhe të edukimit fizik, si dhe duke inkurajuar krijimin e institucioneve të orientuara në edukimin Olimpik, siç janë Akademia Olimpike Kombëtare, Muzeu Olimpik dhe në programet tjera duke përfshirë ato kulturore që ndërlidhen me Lëvizjen Olimpike.
 - b. Të sigurojë mbikëqyrjen e Kartës Olimpike në Kosovë;
 - c. Inkurajimi dhe promovimi i sportit me performancë të lartë dhe aktivitetit fizik në Republikën e Kosovës;
 - d. Propozimi dhe zbatimi i masave për përmirësimin dhe zhvillimin e sportit;
 - e. Pjesëmarrja në hartimin dhe zbatimin e akteve të planifikimit strategjik të sportit;
 - f. Koordinimi dhe monitorimi i aktiviteteve të anëtarëve të vet;
 - g. Bashkëpunimi për zbatimin e aktiviteteve në terren për zhvillimin e sportit me organizatat e tjera sportive dhe institucionet përgjegjëse në sport;

- h. Mbështetja dhe promovimi i arritjeve kulminante sportive të sportistëve dhe pjesëmarrjes së tyre në ekipet shtetërore sportive në Lojërat Olimpike, kampionatet dhe garat e tjera ndërkombëtare;
 - i. Pjesëmarrja në vlerësimet e mbështetjes financiare për federatat, sportistët dhe trajnerët, që si proces udhëhiqet nga Agjencia e Sportit;
 - j. Pjesëmarrja në zbatimin e aktiviteteve të rregullta në lidhje me zbatimin e rregullave dhe luftimin e dukurive negative dhe antidopingut në sport;
 - k. Bashkëpunimi me federatat për promovimin e punës profesionale në sport dhe kujdesi për aftësimin dhe zhvillimin e personave profesionalë në sport;
 - l. Koordinimi i anëtarëve për përgatitjen e protokolleve, udhëzuesve dhe manualeve për çështje të ndryshme të rëndësishme për sportin;
 - m. Ndërmarrja e veprimeve ndaj çdo forme të diskriminimit apo dhunës në sport;
 - n. Promovimi dhe mbështetja e masave lidhur me përkujdesjen mjekësore dhe shëndetësore të sportistëve;
 - o. Në rast të fillimit të procedurës së shpërbërjes së federatës sportive të caktuar ose pamundësisë së veprimit nga federata përkatëse sportive, vendos për marrjen përsipër të përfaqësueses shtetërore dhe kujdeset për mbrojtjen e interesave të sportistëve dhe të drejtave të fituara në nivel ndërkombëtar;
 - p. Të propozojë kandidaturat për organizimin e garave dhe aktiviteteve ndërkombëtare shumëdisiplinare në Kosovë, duke i respektuar parimet e ligjeve të zbatueshme të Kosovës dhe aktet normative të organizatës ndërkombëtare përkatëse;
 - q. Mbi bazën e kërkesës së federatës përkatëse sportive, KOK lëshon rekomandimin lidhur me natyralizimin e sportistëve të huaj të cilët do të përfaqësojnë Republikën e Kosovës, në pajtim me ligjet e zbatueshme të Kosovës;
 - r. KOK ofron opinion për Ministrinë përgjegjëse për sport lidhur me klasifikimin e sportit në përputhje me standardet e përcaktuara të autoritetit përgjegjës ndërkombëtar;
 - s. Të ndihmojë në trajnimin e administratorëve të sportit.
 - t. Të miratojë dhe zbatojë Kodin Botëror të Anti-Dopingut, duke siguruar se politikat dhe rregullat e KOK për anti-doping, të anëtarëve dhe/ose kërkesat për fonde, si dhe procedurat e menaxhimit të rezultateve janë në pajtim me Kodin Botëror për Anti-Doping dhe respektojnë të gjitha rolet dhe përgjegjësitë për Komitetet Olimpike Kombëtare që janë të listuara brenda Kodit Botëror për Anti-Doping.
 - u. Të inkurajojë dhe të mbështesë masat lidhur me kujdesin mjekësor dhe shëndetin e sportistëve.
3. KOK ka autoritetin ekskluziv për përfaqësimin e Kosovës në Lojërat Olimpike si dhe në garat multi-sportive regionale, kontinentale dhe botërore dhe do të themelojë, organizojë dhe do të udhëheqë delegacionet e tyre respektive në ngjarjet dhe garat e tilla. KOK do të vendosë në hyrjen e sportistëve të propozuar nga federatat respektive kombëtare. Përzgjedhja e tillë duhet të bazohet jo vetëm në performancën sportive por, po ashtu edhe në shkathtësitë e tyre të shërbejnë si një shembull për sportistët e rinj të vendit. KOK duhet të sigurojë se propozimet e federatave janë në harmoni me të gjitha dispozitat e Kartës Olimpike. Për më tepër, KOK është përgjegjës për sjelljen e anëtarëve të delegacionit të tij.
 4. KOK është i obliguar të marrë pjesë në Lojërat e Olimpiadës duke i dërguar sportistët
 5. KOK ka autoritet ekskluziv të përzgjedh dhe të përcaktojë qytetin i cili mund të aplikojë të organizojë në Kosovë Lojërat Olimpike ose garat multi-sportive regjionale, kontinentale dhe botërore, që janë nën patronatin e KON-it.
 6. KOK do të bashkëpunojë me institucionet dhe organizatat sportive siç përcaktohet me Ligjin për Sport si dhe organizatat e tjera në fushën e sportit në vend për arritjen e qëllimeve të tij.
 7. KOK, në frymën e bashkëpunimit, delegon përfaqësuesin e vet në Këshillin Shtetëror për Sport si dhe në të gjitha institucionet dhe organizatat e tjera kur një gjë e tillë kërkohet dhe/ose parashihet me legjislacionin në fuqi.

8. KOK duhet të ruajë autonominë e tij dhe t'i rezistojë të gjitha presioneve të çdo lloji, duke përfshirë por jo duke u kufizuar vetëm në presionet politike, ligjore, religjioze ose ekonomike që mund ta parandalojnë nga përputhja me Kartën Olimpikë.
9. KOK mund të asistojë federatat sportive kombëtare ose asociacionet të zhvillojnë dhe promovojnë sportin e tyre si dhe sportistët në Kosovë, në kuadër të kornizës së Kartës Olimpikë dhe rregullave të aplikueshme të Federatave Sportive Ndërkombëtare përkatëse.
10. Për t'i arritur objektivat e tij, KOK duhet të kërkojë burime të financimit në mënyrën që është në pajtim me Kartën Olimpikë.
11. KOK mund të bashkëpunojë me Komitetet tjera Olimpikë Kombëtare.
12. KOK mund të themelojë nën-komisione të veçanta ose Komisione për të ndihmuar në realizimin e detyrave të tij në kuadër të jurisdiksionit të tij.
13. KOK mund të përdorë simbolin Olimpik, flamurin, moton dhe himnin (që janë pasuri ekskluzive e KON-it) vetëm në kuadër të aktiviteteve të tij jo-profitabile, duke siguruar se përdorimi i tillë kontribuon në zhvillimin e Lëvizjes Olimpikë dhe nuk shmanget nga dinjiteti i tij, dhe siguron se ai paraprakisht ka marrë aprovimin e KON-it, në pajtim me Kartën Olimpikë. Të gjitha pasuritë, duke përfshirë por pa u kufizuar, simbolin Olimpik, flamurin, moton, himnin, identifikimet (duke përfshirë por pa u kufizuar në "Lojërat Olimpikë" dhe "Lojërat e Olimpiadës"), dizajnimet, emblemat, flakën dhe pishtarin, dhe të gjitha të drejtat ndaj pasurisë Olimpikë, veç e veç dhe në tërësi, si dhe e drejta për përdorimin e tyre, i takojnë ekskluzivisht KON-it. KOK është përgjegjës ndaj KON-it për mbikëqyrjen në Kosovë të Rregullës 7-14 dhe akteve nënligjore 7-14 të Kartës Olimpikë. Ai do të marrë hapa për të ndaluar çdo përdorim të pasurisë Olimpikë, çfarëdo qoftë, që do të ishte në kontradiktë me rregullat e tilla dhe aktet nënligjore. Ai po ashtu do të angazhohet të mbrojë pasurinë Olimpikë të KON-it, për të mirën e KON-it.
14. KOK do të ushtrojë të gjitha autorizimet, të drejtat dhe obligimet e një Komiteti Olimpik Kombëtar ashtu si i janë dhënë nga Karta Olimpikë dhe nga KON-i.

Neni 5 - Anëtarësimi

1. Në harmoni me Kartën Olimpikë, KOK duhet të përfshijë si anëtarë me të drejtë vote:
 - a. Çdo anëtar të KON-it nga Kosova. Ky anëtar, nëse ekziston, ka të drejtë vote në Asamblenë e Përgjithshme të KOK dhe është anëtar ex-officio i Bordit Ekzekutiv të KOK me të drejtë vote.
 - b. Të gjitha federatat kombëtare të anëtarësuara në Federatat Ndërkombëtare që drejtojnë sportet e përfshira në programin e Lojërave Olimpikë. Përfaqësuesit e këtyre federatave duhet të përbëjnë shumicën votuese të Asamblesë së Përgjithshme të KOK.
 - c. Federatat kombëtare të anëtarësuara në Federatat Ndërkombëtare të njohura nga KON, sportet e të cilave nuk janë të përfshira në programin e Lojërave Olimpikë.
 - d. Një numër i kufizuar (jo më shumë se 6) i organizatave sportive kombëtare të anëtarësuara në federata të tjera ndërkombëtare, bazuar në vendimin e KOK.
 - e. Së paku dy përfaqësues të zgjedhur të sportistëve, të cilët kanë marrë pjesë në të paktën një nga tri edicionet e fundit të Lojërave Olimpikë. Kjo kërkesë zbatohet vetëm pas pjesëmarrjes së parë të KOK në Lojërat Olimpikë.
 - f. Anëtarët votues të KOK duhet të plotësojnë kriteret e përcaktuara me legjislacionin në fuqi të Republikës së Kosovës për mënyrën e veprimtarisë së tyre si dhe përmbushjen e kriterëve të tjera gjatë regjistrimit si federatë sportive;
2. Përveç kësaj, KOK mund të përfshijë si anëtarë pa të drejtë vote:
 - a. Një numër të kufizuar të grupeve multi-sportive dhe organizatave të tjera me orientim sportiv ose përfaqësuesit e tyre, si dhe qytetarë të Kosovës që mund të përforcojnë efektivitetin e KOK ose që kanë dhënë shërbime të jashtëzakonshme për kauzën e sportit dhe të olimpizmit.
3. Kualifikimet për anëtarësim:
 - a. Anëtarët dhe/ose përfaqësuesit e entiteteve anëtare të KOK duhet të plotësojnë këto kushte:

- i. Të jenë qytetarë të Republikës së Kosovës.
 - ii. Të gëzojnë të drejta civile dhe të mos kenë qenë të dënuar për vepra penale.
 - iii. Të jenë themeluar ligjërisht dhe të jenë të anëtarësuar në Federatat Ndërkombëtare përkatëse (për federatat kombëtare);
 - iv. Të veprojnë në përputhje me Kartën Olimpikë, Kodin e KON-it për Etikë, Kodin Botëror për Anti-Doping dhe këtë Statut.
- b. KOK njihet vetëm një federatë kombëtare për çdo sport të drejtuar nga një Federatë Ndërkombëtare.
 - c. Për t'u njohur nga KOK dhe për t'u pranuar si anëtare, një federatë kombëtare duhet të realizojë aktivitete të veçanta, reale dhe të vazhdueshme sportive; të jetë e anëtarësuar në një Federatë Ndërkombëtare të njohur nga KON; dhe të funksionojë plotësisht në përputhje me Kartën Olimpikë dhe rregullat e federatës ndërkombëtare përkatëse.
 - d. Qeveria dhe autoritetet e tjera publike nuk mund të emërojnë asnjë anëtar të KOK.
 - e. Një anëtar i përjashtuar nga KON nuk mund të jetë anëtar i KOK.
 - f. Anëtarët e KOK, përveç administratorëve profesionistë sportivë, nuk do të marrin kompensim apo bonus të çfarëdo lloji për shërbimet ose performancën e tyre. Ata mund të rimbursohen vetëm për udhëtim, akomodim dhe shpenzime të tjera të arsyeshme që dalin nga përmbushja e funksionit të tyre.
4. Aplikimi për anëtarësim:
- a. Aplikacionet me shkrim duhet të dorëzohen te Bordi Ekzekutiv i KOK për shqyrtim dhe, nëse përmbushin kërkesat e Statutit, aplikacioni dorëzohet për vendim në Asamblenë e Përgjithshme të radhës.
 - b. Dosja e aplikimit duhet të përmbushë kriteret e përcaktuara nga KOK në përputhje me këtë Statut dhe të përfshijë të gjitha dokumentet e nevojshme.
 - c. Titulli "Anëtar Nderi" mund të jepet nga Asambleja e Përgjithshme (me propozim të Bordit Ekzekutiv) për persona që kanë dhënë kontribut të jashtëzakonshëm për Lëvizjen Olimpikë dhe sportin në Kosovë.
5. Të drejtat dhe detyrat e anëtarëve:
- a. Anëtarët votues kanë të drejtë të votojnë, të zgjedhin, të jenë të zgjedhur dhe të nominojnë përfaqësues për zgjedhje në organet drejtuese të KOK.
 - b. Anëtarët pa të drejtë vote mund të ndjekin mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme vetëm me të drejtë diskutimi.
 - c. Anëtarët kanë të drejtë të informohen rregullisht për aktivitetet e KOK dhe detyrim të informojnë rregullisht KOK për aktivitetet e tyre.
 - d. Anëtarët mund të përfitojnë nga mbështetja dhe asistencë e KOK për zhvillimin e aktiviteteve të tyre, nëse është e nevojshme dhe e kërkuar, dhe sipas mundësive dhe vendimit të KOK.
 - e. Anëtarët duhet të marrin pjesë aktivisht në punën, mbledhjet dhe aktivitetet e KOK.
 - f. Anëtarët janë të obliguar të respektojnë dhe zbatojnë vendimet e organeve drejtuese të KOK.
 - g. Anëtarët duhet të veprojnë në përputhje me Kartën Olimpikë, Kodin e KON-it për Etikë, Statutin e KOK dhe (për persona juridikë) rregullat dhe rregulloret e tyre.
 - h. Federatat Kombëtare do të bashkëpunojnë ngushtë me KOK, veçanërisht në përgatitjen dhe përzgjedhjen e sportistëve të Kosovës për Lojërat Olimpikë dhe garat multi-sportive regjionale, kontinentale dhe botërore nën patronatin e KON.
 - i. Anëtarët do të ushtrojnë çdo të drejtë dhe do të përmbushin çdo detyrë tjetër në përputhje me këtë Statut dhe Kartën Olimpikë.
6. Ndërprerja e anëtarësisë:
- a. Një anëtar mund t'i ndëpriet anëtarësia në rast të:
 - i. Vdekjes;
 - ii. Dorëheqjes;

- iii. Humbjes se kapacitetit;
- iv. Humbjes së kualifikimit për anëtarësim;
- v. Shpërndarjes së federatës/organizatës;
- vi. Përfshirje për shkak të shkeljes së Kartës Olimpike dhe këtij Statuti.

7. Masat dhe sanksionet:

- a. Në rast të mosrespektimit të detyrimeve, shkeljes së Kartës Olimpike, Kodit për Etikë të KON-it, Statutit të KOK, ose moszbatimit të vendimeve të organeve drejtuese të KOK, mund të merren masat vijuese (në varësi të rëndësisë së fakteve dhe shkallës së shkeljes):
 - i. Vërejtje;
 - ii. Suspendim;
 - iii. Përfshirje;
- b. Vendimi për vërejtje merret nga Bordi Ekzekutiv pasi t'i jepet anëtarit mundësia të dëgjohet. Bordi Ekzekutiv e paraqet rastin në mbledhjen e radhës të Asamblesë së Përgjithshme.
- c. Vendimi për suspendimin e anëtarit duhet të merret nga Bordi Ekzekutiv pasi t'i jipet mundësia anëtarit në fjalë që të dëgjohet. Vendimi i tillë duhet të merret nga së paku dy të tretat (2/3) e votave të anëtarëve të Bordit Ekzekutiv. Bordi Ekzekutiv do të raportojë për rastin në mbledhjen e radhës të Asamblesë së Përgjithshme. Anëtarin në fjalë mund të vendos të ankojë në Asamblesë e Përgjithshme e cila, në këtë rast, duhet të vendos që të konfirmojë vendimin e Bordit Ekzekutiv ose të anulojë suspendimin.
- d. Vendimi për përfshirje të një anëtarit duhet të bëhet nga Asambleja e Përgjithshme dhe pasi t'i jetë dhënë një mundësi e arsyeshme që të dëgjohet anëtarin në fjalë. Një vendim i tillë duhet të merret me shumicën e votave, nga së paku dy të tretat (2/3) e votave të delegatëve me të drejtë vote dhe prezent në Asamblesë e Përgjithshme.

8. Regjistri i anëtarëve:

- a. Sekretari i Përgjithshëm duhet të mbajë një regjistrë të përditësuar të anëtarëve, i cili përfshin: emrin dhe adresën e anëtarit; datën e pranimit; kopjen e vendimit ose procesverbalit të Asamblesë përkatëse; kategorinë dhe statusin e anëtarësisë. Ky regjistër duhet të jetë i disponueshëm në çdo kohë dhe të shërbejë si referencë për thirrjen e mbledhjeve të KOK.

Neni 6 – Organet drejtuese

1. Organet drejtuese të KOK janë si më poshtë:

- a. Asambleja e Përgjithshme, e cila është organi suprem vendimmarrës i KOK.
- b. Bordi Ekzekutiv, i cili është organ menaxhues dhe ekzekutiv i KOK.

Neni 7 - Asambleja e përgjithshme

1. Përbërja e Asamblesë së Përgjithshme është si më poshtë:

- a. Anëtar(et) e KON nga Kosova (nëse ka), me të drejtë vote.
- b. Tre përfaqësues (dy meshkuj dhe një femër, ose anasjelltas) nga secila federatë kombëtare që janë anëtare të Federatave Ndërkombëtare përkatëse të sporteve në programin e Lojërave Olimpike, me një të drejtë vote secili. Këta përfaqësues, të autorizuar nga secila federatë, duhet të jenë anëtarë aktivë të organit ekzekutiv të federatës përkatëse (duke përfshirë, nëse është e mundur, Presidentin e saj). Në përputhje me Kartën Olimpike, këto federata/përfaqësuesit e tyre duhet të përbëjnë shumicën votuese të Asamblesë së Përgjithshme.

- c. Dy përfaqësues nga secila federatë kombëtare e anëtarësuar në Federatat Ndërkombëtare të sporteve që nuk janë pjesë e programit të Lojërave Olimpikë, me një votë secili. Këta përfaqësues, të autorizuar nga federatat përkatëse, duhet të jenë anëtarë aktivë të organit ekzekutiv të federatës (duke përfshirë, nëse është e mundur, Presidentin).
- d. Një përfaqësues nga secila organizatë tjetër sportive e theksuar në Nenin 5.1.d të këtij Statuti, me një votë secili. Përfaqësuesit duhet të jenë anëtarë aktivë të organit ekzekutiv të organizatës përkatëse (duke përfshirë, nëse është e mundur, Presidentin).
- e. Dy përfaqësues të sportistëve (nëse është e mundur, një mashkull dhe një femër), të zgjedhur nga Komisioni i Sportistëve të KOK, i formuar në përputhje me udhëzimet e KON-it ose të Asamblesë së Përgjithshme, me një votë secili. Këta përfaqësues duhet të kenë marrë pjesë së paku në një nga tri edicionet e Lojërave Olimpikë (Kjo kërkesë do të aplikohet vetëm pas pjesëmarrjes së parë të KOK në Lojërat Olimpikë).
- f. Anëtarët e tjerë të përmendur në Nenin 5.2.a të këtij Statuti, pa të drejtë vote.
- g. Anëtarët e nderit të KOK, pa të drejtë vote.

2. Autorizimet e Asamblesë së Përgjithshme si organi më i lartë drejtues i KOK janë si në vijim:

- a. Miraton agjendën dhe procesverbalin e mbledhjes së kaluar.
- b. Përcakton dhe miraton planin strategjik dhe politikat e përgjithshme të KOK;
- c. Dëgjon, shqyrton dhe miraton raportin vjetor të aktiviteteve të KOK të paraqitur nga Bordi Ekzekutiv, si dhe objektivat dhe planin veprues për vitin vijues;
- d. Shqyrton dhe miraton pasqyrat financiare të audituara të vitit të kaluar dhe buxhetin vjetor për vitin vijues të propozuar nga Bordi Ekzekutiv i KOK;
- e. Zgjedh anëtarët e Bordit Ekzekutiv.
- f. Zgjedh anëtarët e Komisionit të Pavarur Zgjedhor për Asamblenë e Përgjithshme Zgjedhore.
- g. Zgjedh auditorin e pavarur për vlerësimin e pasqyrave financiare vjetore të KOK;
- h. Miraton ose refuzon pranimin e çdo anëtari të KOK;
- i. Vendosi për përjashtimin e ndonjë anëtari (me së paku 2/3 e votave të anëtarëve votues të pranishëm), në përputhje me procedurat e apelimit sipas Nenit 5.7.c të këtij Statuti;
- j. Cakton tarifën e anëtarësimit, nëse është e aplikueshme.
- k. Pranon ndihma materiale, financiare, sponsorizime apo donacione në përputhje me Statutin;
- l. Shqyrton dhe miraton Statutin dhe çdo ndryshim të tij (me së paku 2/3 e votave të anëtarëve votues të pranishëm).
- m. Shqyrton dhe miraton aktet nënligjore ose rregulloret e brendshme të propozuara nga Bordi Ekzekutiv që nuk janë në kundërshtim me Statutin ose Kartën Olimpikë.
- n. Interpretin Statutin (duke iu nënshtruar dispozitave të Kartës Olimpikë), nëse ka raste të tilla.
- o. Vendosi për shpërbërjen e KOK (në prani të kuorumit prej 2/3 të anëtarëve votues dhe me së paku 2/3 e votave të pranishme).
- p. Realizon çdo të drejtë tjetër të paraparë me këtë Statut.
- q. Vendosi për çdo çështje që ndodhet në agjendën e saj apo që nuk është e rregulluar me këtë Statut por që bie nën juridiksionin e Kartës Olimpikë.

3. Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme:

- a. Asambleja e Përgjithshme mbledhet në seanca të rregullta të paktën një herë në vit. Data e mbledhjes caktohet nga Bordi Ekzekutiv.
- b. Ftesa për mbledhje nënshkruhet nga Presidenti dhe u dërgohet anëtarëve të paktën tridhjetë (30) ditë para mbledhjes, duke përfshirë datën, orën, vendin dhe agjendën, si dhe dokumentet përkatëse.
- c. Asambleja e Përgjithshme mund të procedojë në mënyrë të rregullt për çështjet e parapara me agjendën e saj. Propozimet nga anëtarët lidhur me agjendën duhet të arrijnë të Presidenti dhe/ose të Sekretari të Përgjithshëm, jo më vonë se njëzet e një (21) ditë para datës së mbledhjes. Nëse duhet të

- bëhet ndonje modifikim në agjendë, agjenda përfundimtare duhet t'iu komunikohet anëtarëve jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë para datës së mbledhjes.
- d. Një mbledhje e jashtëzakonshme e Asamblesë së Përgjithshme mund të ftohet kurdo që është e domosdoshme me kërkesën e Presidentit, dhe/ose të Bordit Ekzekutiv dhe/ose të së paku pesëdhjetë përqind plus një (50% + 1) të anëtarëve votues të Asamblesë së Përgjithshme, duke përfillur procedurat e njejta dhe afatet e fundit.
 - e. Mbledhjet drejtohen nga Presidenti ose, në mungesë të tij, nga Nën-Presidenti i Parë (ose përkatësisht i Dytë/Tretë etj., në mungesë të mëparësve).
 - f. Përveç nëse është përcaktuar ndryshe me këtë Statut, kuorumi i kërkuar për Asamblenë e Përgjithshme është së paku gjysma (50% +1) e delegatëve votues, duke përfshirë shumicën votuese të delegatëve të federatave të sporteve Olimpikë. Nëse ky kuorum nuk mund të arrihet, mbledhja duhet të shtyhet për shtatë (7) ditë. Nëse kuorumi nuk arrihet as në mbledhjen e dytë, mbledhja do të mbahet, nëse prezent janë së paku një e treta (1/3) e anëtarëve votues, me kusht që shumica e votuesve janë delegatët e federatave të sporteve Olimpikë.
 - g. Vendimet do të merren nga Asambleja e Përgjithshme nga së paku gjysma (50% +1) e votave të delegateve votues që janë prezent, përveç nëse është përcaktuar ndryshe me këtë Statut.
 - h. Në rast të barazimit, Kryesuesi i mbledhjes do ta ketë votën vendimtare.
 - i. Votimi bëhet me vota të hapura ose të fshehta ashtu si vendoset nga Asambleja e Përgjithshme, përveç për zgjedhjen e anëtarëve dhe sanksionet kundër anëtarëve, votimi do të jetë me vota të fshehta.
 - j. Votimi proxy (me autorizim) nuk lejohet.
 - k. Shumica e votuesve të Asamblesë së Përgjithshme duhet të përbëhet gjithmone nga delegatët e federatave kombëtare të anëtarësuar në Federatat Ndërkombëtare që drejojnë sportet që janë në programin e Lojërave Olimpikë.
 - l. Për çështjet që kanë të bëjnë me Lojërat Olimpikë, merren në konsideratë vetëm votat e delegatëve të federatave kombëtare anëtare të Federatave Ndërkombëtare që drejojnë sportet e përfshira në programin e Lojërave Olimpikë.
 - m. Zgjedhjet për Bordin Ekzekutiv mbahen çdo katër (4) vjet, brenda gjashtë (6) muajve pas Lojërave Olimpikë Verore, gjatë mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme e cila duhet ta përfshijë në agjendën e saj këtë pikë.
 - n. Zgjedhjet zhvillohen sipas procedurave të këtij Statuti.
 - o. Procesverbalet e mbledhjeve me zgjedhje ose zëvendësime duhet t'i dërgohen KON-it, të nënshkruara dhe të certifikuara nga Presidenti dhe Sekretari i Përgjithshëm i KOK. Të gjitha dokumentet duhet të certifikohen si kopje të vërteta nga Presidenti dhe Sekretari i Përgjithshëm i KOK.
 - p. Sekretari i Përgjithshëm (ose një anëtar tjetër i caktuar nga Presidenti) është përgjegjës për përpilimin e procesverbalit, i cili duhet të shpërndahet te të gjithë anëtarët brenda 30 ditëve pas mbledhjes.
4. Procedurat Zgjedhore për anëtarët e Bordit Ekzekutiv duhet të jenë si në vijim:
- a. Në Asamblenë e Përgjithshme para asaj zgjedhore, Asambleja e Përgjithshme zgjedh një komision të pavarur zgjedhor i cili do të jetë plotësisht përgjegjës për zhvillimin, monitorimin dhe udhëheqjen e procesit zgjedhor në tërësi (nga pranimi i nominimeve deri te shpallja e rezultateve finale). Ky komisioni i pavarur zgjedhor duhet të përbëhet nga tre (3) anëtarë, duke përfshi Kryesuesin dhe dy (2) anëtarë rezervë (nëse është e nevojshme). Asnjë nga këta anëtarë nuk mund të jetë kandidat për organe ekzekutive. Ata duhet të jenë të pavarur dhe neutralë, biografi legjitime, të kenë integritet dhe mos të kenë konflikt interesi me zgjedhjet.
 - b. Formularët e nominimit duhet të dërgohen tek të gjithë anëtarët votues të Asamblesë së Përgjithshme jo më vonë se tridhjetë (30) ditë para zgjedhjeve, së bashku me paralajmërimin për mbledhje.

- c. Nominimet mund të dorëzohen në komisionin e pavarur zgjedhor nga çdo anëtar votues i Asamblesë së Përgjithshme jo më vonë se katërmëdhjetë (14) ditë para zgjedhjeve.
- d. Të nominuarit për pozitën e Presidentit duhet të jenë anëtarë ekzekutivë të një Federate Kombëtare të anëtarësuar në një Organizatë Ndërkombëtare e cila drejton një sport të përfshirë në programin e Lojërave Olimpike (në momentin kur organizohen zgjedhjet në KOK).
- e. Kur ata i dorëzojnë nominimet e tyre, të nominuarit për pozitën e Presidentit duhet poashtu të dërgojnë te komisioni i pavarur zgjedhor një përmbledhje të shkurtër të vizionit dhe programit të tyre, i cili do t'iu dërgohet anëtarëve me të drejtë vote, jo më vonë se 6 ditë para zgjedhjeve.
- f. Komisioni zgjedhor i pavarur do të shqyrtojë nominimet e pranuar dhe do të njoftojë anëtarët votues të Asamblesë së Përgjithshme për emrat dhe biografinë e shkurtër të kandidatëve të përshtatshëm jo më vonë se dhjetë (10) ditë para zgjedhjeve. Çdo kundërshtim/apel objektiv nga ndonjë anëtar votues duhet të dorëzohet te Komisioni i pavarur zgjedhor jo më vonë se tetë (8) ditë para zgjedhjeve. Komisioni i pavarur zgjedhor do të shqyrtojë kundërshtimin/apelin dhe do të marrë vendimin jo më vonë se gjashtë (6) ditë para zgjedhjeve dhe, në këtë rast, do të informojë të gjithë anëtarët votues. Në rast të çfarëdo dileme për përshtatshmërinë apo mospërshtatshmërinë e kandidatit, komisioni i pavarur zgjedhor do të referojë rastin në Asamblenë e Përgjithshme për vendimin final të Asamblesë së Përgjithshme para procedimit me votime.
- g. Zgjedhjet duhet të organizohen për çdo pozitë, njëra pas tjetrës dhe me vota të fshehta.
- h. Komisioni i pavarur zgjedhor duhet të përgatisë kutinë transparente të votimit dhe fletët e votimit që do t'u ipen delegatëve votues të Asamblesë së Përgjithshme.
- i. Komisioni i pavarur zgjedhor duhet të sqarojë procedurën zgjedhore dhe do të përgjigjet ose të sqarojë çdo pyetje para fillimit të procedurës së votimit.
- j. Pasi të gjithë delegatët votues prezent janë ftuar të votojnë nga komisioni i pavarur zgjedhor, komisioni i pavarur zgjedhor do ta hapë kutinë e votimit dhe do t'i numërojë votat publikisht.
- k. Nëse është një ose dy kandidatë për një pozicion, kandidati që merr së paku 50% + 1 të votave valide do të deklarohet i zgjedhur.
- l. Nëse ka më shumë se dy kandidatë dhe asnjëri nuk merr së paku 50% + 1 të votave valide në rundin e parë, atëherë do të organizohet rundi i dytë midis dy kandidatëve që kanë marrë numrin më të madh të votave valide në rundin e parë. Në këtë rundin e dytë, kandidati që merr 50% + 1 të votave valide do të deklarohet i zgjedhur.
- m. Pas zgjedhjes, Presidenti mund të propozojë tre anëtarë të zgjedhen si anëtarë të Bordit Ekzekutiv nga e njëjta Asamble e Përgjithshme zgjedhore, në pajtim me Nenin 6.1.a.vi të këtij Statuti.
- n. Komisioni i pavarur zgjedhor do të shpallë rezultatet e zgjedhjeve dhe do të shqyrtojë dhe marrë vendime për çdo çështje/ankesë që mund të ngritet nga cilido delegat votues para mbylljes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme.
- o. Të dy gjinitë duhet të jenë të përfaqësuar në Bordin Ekzekutiv.
- p. Siç përmendet në Kartën Olimpike, përfaqësuesit e zgjedhur të federatave kombëtare anëtare të Federatave Ndërkombëtare që drejtojnë sportet e përfshira në programin e Lojërave Olimpike, duhet të përbëjnë shumicën votuese në Bordin Ekzekutiv.

Neni 8 – Bordi Ekzekutiv

1. Përbërja e Bordit Ekzekutiv të KOK

- a. Bordi Ekzekutiv duhet të përbëhet nga anëtarët votues të Asamblesë së Përgjithshme të zgjedhur si në vijim:

- i. Presidenti;
 - ii. Nën-Presidenti i Parë;
 - iii. Nën-Presidenti i Dytë;
 - iv. Nën-Presidenti i Tretë;
 - v. Nën-Presidenti i Katërt;
 - vi. Jo më shumë se 10 anëtarë, duke përfshirë së paku një përfaqësues të sportistëve të zgjedhur nga Komisioni i sportistëve të KOK ose nga Asambleja e Përgjithshme dhe tre anëtarë të propozuar nga Presidenti (i posazgjedhur) për t'u zgjedhur në Asamblenë e njëjtë zgjedhore.
- b. Anëtarët e KON-it nga Kosova, nëse ka, janë anëtarë ex-officio (sipas funksionit) të Bordit Ekzekutiv me të drejtë vote.
 - c. Brenda këtyre 15 anëtarëve votues të zgjedhur në Bordin Ekzekutiv, përfaqësuesit e federatave kombëtare anëtare të Federatave Ndërkombëtare që drejtojnë sporte të përfshira në programin e Lojërave Olimpike duhet gjithmonë të përbëjnë shumicën votuese të Bordit Ekzekutiv.
 - d. Sekretari i Përgjithshëm dhe Arkëtari duhet të jenë administratorë profesionistë (me kontratë pune) të cilët duhet të demonstrojnë kualifikime përkatëse dhe shkathtësi për të realizuar këto funksione në rregull. Ata duhet të emërohen (të largohen) nga Bordi Ekzekutiv sipas propozimit të Presidentit. Ata duhet të përcjellin mbledhjet e Bordit Ekzekutiv me të drejtë të diskutojnë por pa të drejtë vote.
 - e. Presidenti dhe Sekretari i Përgjithshëm duhet të plotësojnë kushtet në vijim:
 - I. Ai/ajo duhet të jetë qytetar/shtetas i Kosovës.
 - II. Ai/ajo duhet të ketë të përfunduar Universitetin ose shkollimin e lartë të shkallës së njëjtë.
 - III. Ai/ajo duhet të ketë përvojë minimale në Lëvizjen sportive dhe njohuri të Lëvizjes Olimpike.
 - IV. Ai/ajo duhet të jetë në gjendje të flasë së paku njërën nga dy gjuhët zyrtare të KON-it (Anglishten ose Frëngjishten).

2. Mandati i anëtarëve të zgjedhur të Bordit Ekzekutiv:

- a. Anëtarët e Bordit Ekzekutiv duhet të zgjedhen me mandate që nuk tejkalon 4 vite, sipas procedurave të parapara për zgjedhje në këtë Statut. Ata mund të rizgjedhen (natyrisht nëse dëshmojnë se ende i plotësojnë kushtet e kërkuara).

3. Vendet vakante:

- a. Një anëtar i Bordit Ekzekutiv humb të drejtën e anëtarit në rast të
 - i. Vdekjes.
 - ii. Dorëheqjes.
 - iii. Mungesës së paarsyetuar në tri (3) mbledhje të njëpasnjëshme të Bordit Ekzekutiv.
 - iv. Largimit ose përjashtimit sipas vendimit të Asamblesë së Përgjithshme nga shumica e së paku të dy të tretave (2/3) të votave të delegatëve votues prezent në Asamblenë e Përgjithshme pasi t'i jetë dhënë mundësia e arsyeshme delegatit në fjalë për t'u dëgjuar nga Asambleja e Përgjithshme.
- b. Çdo vend vakant i paraqitur në Bordin Ekzekutiv do të plotësohet përkohësisht me zgjedhjen e një anëtari të ri nga Bordi Ekzekutiv në bazë të propozimit të Presidentit, deri në Asamblenë e Përgjithshme të radhës në të cilën pozicioni do të plotësohet me zgjedhjen e anëtarit të ri për periudhën e mbetur të mandatit.

4. Autorizimet e Bordit Ekzekutiv:

- a. Të menaxhojë, administrojë dhe udhëheqë KOK-un në pajtim me këtë Statut dhe me planin strategjik, buxhetin dhe politikat e përgjithshme të aprovuara nga Asambleja e Përgjithshme. Bordi Ekzekutiv i përgjigjet për punën e tij Asamblesë së Përgjithshme.
- b. Të bëjë propozime në Asamblenë e Përgjithshme për definimin e planit strategjik, politikave të përgjithshme dhe planin e veprimeve të KOK.
- c. Të zbatojë rezolutat e kaluara nga Asambleja e Përgjithshme.
- d. Të përgatisë gjendjen financiare të audituar, buxhetin vjetor dhe raportet e KOK-ut për t'u paraqitur në Asamblenë e Përgjithshme për aprovim.
- e. Të menaxhojë pasurinë dhe fondet e KOK-ut sipas aprovimit nga Asambleja e Përgjithshme.
- f. Të mbrojë interesin e Lëvizjes Olimpike e Sportive në Kosovë dhe të punojë intensivisht të arrihen qëllimet dhe objektivat e KOK-ut.
- g. Të përcaktojë dhe zgjedhë pjesëmarrësit në Lojëra Olimpike dhe në garat multi-sportive regjionale, kontinentale dhe botërore nën patronatin e KON-it në të cilat Kosova merr pjesë, pas propozimeve të Federatave Kombëtare dhe në bashkëpunim të ngushtë me to.
- h. Të sigurojë asistencë dhe këshilla për Federatat Kombëtare (brenda mjeteve të tij) me qëllim të përmirësojnë zhvillimin dhe operimin e tyre, nëse është e nevojshme.
- i. Të formojë dhe monitorojë komisionet dhe/ose grupet punuese nëse duket e nevojshme të asistojë në arritjen e objektivave të KOK, dhe të nominojë anëtarët e komisioneve të tilla dhe/ose të grupeve punuese.
- j. Të bëjë propozime për anëtarësim të ndonjë anëtari në Asamblenë e Përgjithshme për vendim.
- k. Të draftojë aktet nënligjore dhe rregulloret e brendshme, nëse është e nevojshme, në vijë me këtë Statut dhe me Kartën Olimpike, dhe t'i dorëzojë ato në Asamblenë e Përgjithshme për aprovim.
- l. Të krijojë dhe të zhvillojë marrëdhënie harmonike dhe të frytshme në nivelin ndërkombëtar, me KON-in dhe organizata të tjera sportive regjionale, kontinentale dhe ndërkombëtare si dhe në nivelin kombëtar me autoritetet relevante.
- m. Të zbatojë Kodin e Qeverisjes së Mirë të miratuar nga Ministria përgjegjëse për sport.
- n. Të ndërmarrë veprime disiplinore siç është përmendur në këtë Statut.
- o. Të realizojë çdo detyrë tjetër që parashihet me këtë Statut ose që delegohet nga Asambleja e Përgjithshme.

5. Mbledhjet e Bordit Ekzekutiv:

- a. Bordi Ekzekutiv duhet të takohet së paku katër (4) herë në vit.
- b. Takimet urgjente të Bordit Ekzekutiv mund të ftohen nga Presidenti dhe/ose me kërkesën e gjysmës (50% + 1) të anëtarëve të Bordit Ekzekutiv.
- c. Mbledhjet duhet të ftohen dhe udhëhiqen nga Presidenti. Në mungesë ose pamundësi, Nën-Presidenti i Parë (ose në mungesë ose në pamundësi të Nën-Presidentit të Parë, Nën-Presidenti i Dytë, ose në mungesë ose pamundësi të të dyve, Nën-Presidenti i Tretë etj.) do ta thërrasë dhe udhëheqë mbledhjen.
- d. Mbledhjet e Bordit Ekzekutiv do të ftohen me ftesë për të gjithë anëtarët e Bordit Ekzekutiv jo më vonë se shtatë (7) ditë para mbledhjes duke caktuar datën, orën, vendin dhe agjendën e mbledhjes dhe duke përfshirë edhe të gjitha dokumentet e nevojshme.
- e. Kuorumi i kërkuar për një mbledhje të Bordit Ekzekutiv është së paku gjysma (50% + 1) e anëtarëve votues të Bordit Ekzekutiv.
- f. Të gjithë anëtarët votues të Bordit Ekzekutiv duhet të kenë të drejtën e një vote secili.
- g. Vendimet merren me shumicën e thjeshtë të votave të anëtarëve votues prezent.
- h. Në rast të barazimit, Kryesuesi i mbledhjes e ka votën vendimtare.
- i. Votimi duhet të bëhet me ngritje të dorës ose me votim të fshehtë nëse vendos Bordi Ekzekutiv.
- j. Sekretari i Përgjithshëm (ose në mungesë të tij/saj një anëtar i Bordit Ekzekutiv i përcaktuar nga Kryesuesi) është përgjegjës për formulimin e procesverbalit të mbledhjes së Bordit Ekzekutiv.

Procesverballi duhet t'u shpërndahet të gjithë anëtarëve të Bordit Ekzekutiv brenda shtatë (7) ditëve pas mbledhjes.

6. Përgjegjësitë e Presidentit:

- a. Presidenti është përfaqësuesi legal i KOK në Kosovë dhe jashtë.
- b. Presidenti duhet të veprojë dhe të nënshkruajë si përfaqësues ligjor i KOK.
- c. Presidenti duhet të bashkë-nënshkruajë së bashku me Sekretarin e Përgjithshëm dhe/ose me Arkatarin çdo autorizim financiar ose shpenzim.
- d. Presidenti duhet të ftojë dhe udhëheqë mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme dhe të Bordit Ekzekutiv.
- e. Presidenti duhet të sigurojë mbikëqyrjen e këtij Statuti dhe të Kartës Olimpike në Kosovë.
- f. Presidenti duhet të promovojë parimet Olimpike dhe sjelljet etike në kuadër të Lëvizjes Olimpike në Kosovë.
- f. Presidenti duhet të punojë në ruajtjen dhe përforcimin e marrëdhënieve harmonike me të gjitha autoritetet, institucionet, partnerët dhe palët e interesit në Kosovë dhe jashtë.
- g. Presidenti duhet të performojë, kohë pas kohe, çdo funksion tjetër që mund të përshkruhet nga Asambleja e Përgjithshme ose nga Bordi Ekzekutiv.

7. Përgjegjësitë e Nën-Presidentëve:

- a. Nën-Presidenti, sipas radhës (i Pari, i Dyti, i Treti dhe i Katërti) duhet të performojë detyrat dhe të përmbushë përgjegjësitë e Presidentit në rast të mungesës dhe pamundësisë.
- b. Nën-Presidenti duhet aktivisht të marrë pjesë në punën e organeve drejtuese të KOK.
- c. Nën-Presidenti duhet të performojë, kohë pas kohe, çfarëdo funksioni që mund t'i përshkruhet nga Asambleja e Përgjithshme ose nga Bordi Ekzekutiv ose nga Presidenti.

8. Përgjegjësitë e anëtarëve të tjerë të Bordit Ekzekutiv:

- a. Anëtarët e Bordit Ekzekutiv duhet aktivisht të marrin pjesë në punën e organeve drejtuese të KOK.
- b. Anëtarët e Bordit Ekzekutiv duhet të performojnë, kohë pas kohe, çfarëdo funksioni që mund t'i përshkruhet nga Asambleja e Përgjithshme, ose nga Bordi Ekzekutiv ose nga Presidenti.

9. Përgjegjësitë e Sekretarit të Përgjithshëm:

- a. Sekretari i Përgjithshëm duhet të jetë administrator profesionist me një kontratë pune, i cili duhet të demonstrojë kualifikime të përshtatshme dhe shkathtësi për të kryer funksionin e tillë me sukses. Ai/ajo do të emërohet (dhe largohet) nga Bordi Ekzekutiv me propozimin e Presidentit. Ai/ajo do të përcjellë mbledhjet e Bordit Ekzekutiv me të drejtë diskutimi, por pa të drejtë vote.
- b. Sekretari i Përgjithshëm duhet të menaxhojë administratën dhe stafin e KOK dhe të monitorojë e mbikëqyrë tërë punën administrative sipas direktivave të Asamblesë së Përgjithshme, të Bordit Ekzekutiv dhe të Presidentit.
- c. Sekretari i Përgjithshëm duhet të realizojë të gjitha aranzhimet e nevojshme për mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme dhe të Bordit Ekzekutiv.
- d. Sekretari i Përgjithshëm duhet të përpilojë dhe të mbajë të gjitha të dhënat dhe procesverbalet e mbledhjeve të Asambleve të Përgjithshme dhe të Bordit Ekzekutiv.
- e. Sekretari i Përgjithshëm duhet të mbajë regjistrin e anëtarëve të përditësuar dhe në dispozicion në çdo kohë.
- f. Sekretari i Përgjithshëm duhet të koordinojë punën e komisioneve dhe të grupeve punuese.
- g. Sekretari i Përgjithshëm duhet të kryejë, kohë pas kohe, çdo funksion tjetër që mund t'i përshkruhet nga Asambleja e Përgjithshme, ose nga Bordi Ekzekutiv, ose nga Presidenti.

10. Përgjegjësitë e Arkatarit

- a. Arkëtari duhet të jetë një administrator profesionist me një kontratë pune, i cili duhet të demonstrojë kualifikime të përshtatshme dhe shkathtësi për kryerjen e funksionit në mënyrë të duhur. Ai/ajo do të emërohet (dhe largohet) nga Bordi Ekzekutiv pas propozimit të Presidentit. Ai/ajo duhet të përcjellë mbledhjet e Bordit Ekzekutiv me të drejtën të diskutojë, por pa të drejtë vote.
- b. Arkëtari duhet të pranojë të gjitha pagesat, kotizimet, çdo fond ose pasuri të paguar ose dhuruar si donacion për KOK.
- c. Arkëtari duhet t'i depozitojë të gjitha fondet e pranuar në një bankë të besueshme, në emër dhe si kreditim i KOK, ashtu siç është aprovuar nga Bordi Ekzekutiv.
- d. Arkëtari duhet të mbajë dhe të administrojë llogaritë e KOK.
- e. Arkëtari duhet të mbajë në rregull, saktë dhe të përditësuara të gjitha të dhënat për shpenzimet, të hyrat dhe transaksionet tjera financiare të KOK, të disponueshme në çdo kohë për Bordin Ekzekutiv.
- f. Arkëtari duhet të përgatisë të gjitha raportet dhe buxhetet vjetore për Bordin Ekzekutiv dhe për Asamblenë e Përgjithshme.
- g. Arkëtari duhet të sigurojë që gjendja financiare e KOK të jetë audituar në rregull dhe për çdo vit, nga Auditori i zgjedhur nga Asambleja e Përgjithshme.
- h. Arkëtari duhet të kryejë edhe funksione të tjera, kohë pas kohe, ashtu si i përshkruhen nga Asambleja e Përgjithshme, ose nga Bordi Ekzekutiv, ose nga Presidenti.

Neni 9 – Këshilli i Arbitrazhit Sportiv

1. Në kuadër të KOK funksionon zgjidhja e mosmarrëveshjeve përmes arbitrazhit sportiv që organizohet si trupë e pavarur profesionale.
2. Në kuadër të Këshillit të Arbitrazhit Sportiv vepron edhe Gjykata e Arbitrazhit Sportiv.
3. Këshilli i Arbitrazhit Sportiv është organ kolegjal që drejton, autorizon dhe kryen mbikëqyrjen e përgjithshme të punës së Gjykatës së Arbitrazhit Sportiv. Gjykata e Arbitrazhit Sportiv është tribunal i formuar enkas për çdo mosmarrëveshje që zgjidhet përmes arbitrazhit dhe që përbëhet nga anëtarët e përzgjedhur nga lista e arbitrave dhe ndërmjetësve.
4. Këshilli i Arbitrazhit Sportiv ka detyrën kryesore të ruaj pavarësinë e Gjykatës së Arbitrazhit Sportiv dhe të drejtat e palëve. Për këtë qëllim, Këshilli i Arbitrazhit Sportiv kujdeset për administrimin dhe financimin e Gjykatës së Arbitrazhit Sportiv. Këshilli i Arbitrazhit Sportiv do të ketë nënllogarinë bankare të veçantë në kuadër të llogarisë bankare të KOK.
5. Përbërja e Këshillit të Arbitrazhit Sportiv përcaktohet me Rregulloren e KAS, në përputhje me ligjin përkatës për sport.
6. Anëtarët e Këshillit të Arbitrazhit Sportiv i zgjedh Asambleja e Përgjithshme e KOK për një mandat pesë (5) vjeçar me të drejtë rizgjedhjeje.
7. Kandidati për t'u zgjedhur anëtar në Këshillin e Arbitrazhit Sportiv duhet ti plotësoj kriteret e përcaktuara me ligjin për sport.
8. Anëtarët e Këshillit të Arbitrazhit nuk mund të jenë pjesë në listën e arbitrave ose ndërmjetësve të Gjykatës së Arbitrazhit Sportiv dhe as nuk mund të jenë avokatë ose përfaqësues të palëve në procedurë pranë Gjykatës së Arbitrazhit Sportiv.
9. Anëtarët e Këshillit të Arbitrazhit Sportiv kanë të drejtën e kompensimit financiar për ushtrimin e veprimtarisë së tyre. Mjetet për punën dhe veprimtarinë e Këshillit të Arbitrazhit dhe Gjykatës së Arbitrazhit Sportiv sigurohen nga të hyrat për shqyrtimin dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe nga buxheti i paraparë për KAS në kuadër të KOK, si dhe të hyrat e tjera të cilat mund të sigurohen në përputhje me ligjet e aplikueshme në Kosovë. Të gjitha të hyrat nga procedurat e inicuar në KAS do të transferohen në nënllogarinë e dedikuar për KAS.

10. Detyrat dhe përgjegjësitë e Këshillit të Arbitrazhit Sportiv dhe Gjykatës së Arbitrazhit Sportiv, procedurat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve dhe kompensimi për punën e tyre përcaktohen me akt nënligjor të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e KOK sipas propozimit të Këshillit të Arbitrazhit Sportiv.

Neni 10 – Komisionet dhe grupet punuese

1. Me qëllim të lehtësimit, asistimit dhe përforcimit të punës së KOK, Bordi Ekzekutiv mund të formojë komisione dhe grupe punuese, nëse është e nevojshme.
2. Bordi Ekzekutiv duhet, në veçanti, të formojë komisionet në vijim (së bashku me kushtet korresponduese të referencave për secilin komision):
 - a. Komisioni i sportistëve (subjekt i udhëzimeve të KON-it);
 - b. Komisionin Etik;
 - c. Komisioni për Financa dhe Auditim;
 - d. Komisioni Ligjor;
 - e. Komisioni për Marketing;
 - f. Komisioni Mjekësor;
 - g. Komisioni Femra dhe Sporti;
 - h. Komisioni i Sportit;
 - i. Komisioni për Marrëdhënie Ndërkombëtare;
3. Bordi Ekzekutiv duhet të përcaktojë përbërjen, autorizimet dhe mënyrën e funksionimit të komisioneve dhe grupeve punuese.
4. Bordi Ekzekutiv nuk mund të transferojë asnjë autorizim vendimmarrës në komisione apo grupe punuese.
5. Komisioni i Sportistëve i KOK duhet të formohet dhe të funksionojë në pajtim me udhëzimet e KON-it.

Neni 11 – Akademia Olimpike e Kosovës

1. KOK mund të themelojë Akademinë Olimpikë të Kosovës nën ombrellën e KOK.
2. Akademia Olimpikë e Kosovës do të funksionojë në pajtim me kushtet specifike të referencës të miratuara nga KOK.

Neni 12 - Financat

1. Financat e KOK duhet të rrjedhin nga burimet në vijim:
 - a. Mbështetja financiare nga KON, nga Solidariteti Olimpik dhe nga organizatat e tjera të Lëvizjes Olimpikë;
 - b. Mbështetja financiare e alokuar nga autoritetet përkatëse të Kosovës;
 - c. Kotizimi për anëtarësim, bazuar në vendimin e Asamblesë së Përgjithshme (nëse është i aplikueshëm);
 - d. Të hyrat që rrjedhin nga marketingu dhe aktivitetet sponsoruese dhe përdorimi i emrit dhe
 - e. Donacionet dhe grantet e pranuar nga Bordi Ekzekutiv dhe nga Asambleja e Përgjithshme.
2. Për të arritur objektivat e tij, KOK ka të drejtë të përfitojë nga çfarëdo forme e lejuar financimi sipas legjislacionit në fuqi dhe akteve përkatëse normative të Republikës së Kosovës dhe ministrisë përkatëse për sport, si dhe në pajtim me Kartën Olimpikë.

3. Kontributet dhe fondet specifike të pranuar nga entitetet kombëtare dhe ndërkombëtare duhet të shfrytëzohen në mënyrë strikte për qëllimin e arritjes së objektivave dhe aktiviteteve të KOK, në pajtim me këtë Statut dhe me Kartën Olimpikë.
4. Fondet specifike të alokuara nga programet e Solidaritetit Olimpik duhet të përdoren vetëm për qëllimin e programit të përcaktuar nga Solidariteti Olimpik.
5. Viti financiar i KOK fillon më 1 janar dhe përfundon më 31 dhjetor të të njëjtit vit.

Neni 13 – Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Të gjitha mosmarrëveshjet në mes KOK dhe anëtarëve të tij, mund të zgjidhen me mirëkuptim në një afat prej 15 ditëve nga lindja e mosmarrëveshjes. Në rast se brenda këtij afati nuk mund të zgjidhet mosmarrëveshja me mirëkuptim, atëherë palët drejtohen në KAS.
2. Gjykata e Arbitrazhit Sportiv funksionon në kuadër të Këshillit të Arbitrazhit Sportiv dhe është përgjegjëse për zgjidhjen e kontesteve dhe mosmarrëveshjeve në fushën e sportit dhe antidopingut.
3. Gjykata e Arbitrazhit Sportiv vendos për kontestet në fushën e sportit ndaj KOK, KPK, federatave përkatëse të sportit, të klubeve sportive, federatave e shoqatave shumësportive, dhe personave tjerë fizik dhe juridik të përfshirë në sistemin e sportit, për të cilat konteste janë shtjerrë ose nuk ekzistojnë mjete të tjera të mbrojtjes juridike në kuadër të procedurave të brendshme të atyre organizatave dhe nëse ekziston një marrëveshje mes palëve që mosmarrëveshja e tyre të zgjidhet përmes arbitrazhit sportiv në KAS. Marrëveshja në mes të palëve që mosmarrëveshja e tyre të zgjidhet përmes arbitrazhit sportiv në KAS mund të jetë si klauzolë arbitrazhi në marrëveshje ekzistuese nga e cila buron mosmarrëveshja, një marrëveshje e lidhur në mes të palëve pasi që ka lindur mosmarrëveshja, apo si detyrim për palët që buron nga rregullativa e brendshme e organizatës.
4. Vendimet e GJAS janë të formës së prerë dhe të ekzekutueshme ndaj palëve në arbitrazh, përveç në rastet kur veprohet sipas paragrafit 7 të këtij neni.
5. Për moszbatimin e Vendimit të GJAS nga palët në arbitrazh, Agjencia e Sportit dhe Inspektorati i Sportit ndërmarrin masa dhe sanksione përkatëse ndaj palës moszbatuese ashtu si të parapara me ligjin përkatës për sport.
6. Për moszbatimin e Vendimit të GJAS nga palët në arbitrazh respektivisht nga anëtarët në kuadër të Federatës, Federata dhe Inspektorati ndërmarrin masa dhe sanksione përkatëse të përcaktuara me aktet normative të Federatës dhe dispozitat përkatëse të ligjit për sport.
7. Pala e pakënaqur me vendimin e GJAS mund të parashtrojë ankesë në Gjykatën për Arbitrazh Sportiv me seli në Llozanë - Zvicërr, në afatin e përcaktuar prej 21 ditëve nga data e pranimi të vendimit.

Neni 14 - Papajtueshmëria

1. KOK do të respektojë dispozitat nga ligji i sportit që kanë të bëjnë me papajtueshmërinë në ushtrimin e funksionit apo angazhimit profesional pranë KOK. Këto rregulla do të zbatohen edhe për Këshillin e Arbitrazhit Sportiv dhe Gjykatën e Arbitrazhit Sportiv.

Neni 15 - Shpërbarja

1. KOK mund të shpërbëhet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, në prani të një kuorumi prej së paku dy të tretave (2/3) të anëtarëve me të drejtë vote dhe me një rezolutë të miratuar nga së paku dy të tretat (2/3) e delegatëve votues të pranishëm.

2. Në rast të shpërbërjes, të gjitha obligimet dhe rezervat e fituara ligjërisht në emër të KOK do të dorëzohen në tërësi, dhe fondi do t'i jepet me donacion pasardhësit ligjor ose, nëse një i tillë nuk ekziston, një organizatë që ka objektiva të përafërta, në bazë të vendimit të Asamblesë së Përgjithshme, e cila paraprakisht konsultohet dhe koordinohet me KON-in.

Neni 16 – Dispozitat finale

1. Statuti i KOK duhet, gjatë gjithë kohës, të jetë në përputhje me Kartën Olimpikë, ndaj së cilës duhet të referohet shprehimisht. Në rast të ndonjë dileme sa i përket rëndësisë apo interpretimit të këtij Statuti, ose në rast të ndonjë mospërputhjeje ndërmjet këtij Statuti dhe Kartës Olimpikë, kjo e fundit ka përparësi.
2. Ky Statut duhet të miratohet dhe, më pas, të mund të amendohet nga Asambleja e Përgjithshme me vendimin e dy të tretave (2/3) të votave të delegatëve votues të pranishëm në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme.
3. Statuti i KOK, si dhe çdo ndryshim apo amendament pasues i tij, duhet të dorëzohet në KON për miratim.
4. Statuti i tanishëm hyn në fuqi menjëherë pas miratimit nga Asambleja e Përgjithshme e KOK dhe do të zëvendësojë dhe mbizotërojë çdo Statut të mëparshëm të KOK.

Data e miratimit nga Asambleja e Përgjithshme e KOK: 28 gusht 2025

Nenshkruar nga:

		
President		Sekretari i Përgjithshëm
Komiteti Olimpik i Kosoves		Komiteti Olimpik i Kosoves